

# **IKAF F2 Kontabiliteti Menaxherial**

## **Syllabus dhe Udhëzues Studimi**

*Kualifikimi Teknik Kontabiliteti*  
*(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

### **Struktura e Kualifikimit**

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Teknik Kontabiliteti në të cilën bënë pjesë edhe moduli Kontabiliteti Menaxherial. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

### **Moduli**

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

### **Struktura e Syllabusit**

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Kontabiliteti Menaxherial i cili është pjesë e nivelit Teknik Kontabiliteti. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

### **Udhëzuesi i Studimit**

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuara në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT


## *Kualifikimi Teknik Kontabiliteti*

*(Bazuar në planprogramet e ACCA)*

Programi kualifikues për Teknik të Kontabilitetit, me theks të veçantë mbështetet në aftësitë menaxhuese dhe komunikuese, zhvillimin praktik të biznesit dhe aftësitë planifikuese si dhe po ashtu njohjet më të reja mbi mjedisin tatimor dhe raportimin financiar.

Për t'u trajnuar për Teknik të Kontabilitetit ju duhet të bëheni anëtar student i IKAF-it. Anëtarësimi është i hapur për profesionistë që punojnë në kontabilitet si dhe për ata që janë të interesuar në kontabilitet.

Kandidatët në Kualifikimin për Teknik Kontabiliteti duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulin Kontabiliteti Menaxherial.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve deri tek titulli Teknik Kontabiliteti

## Modulet

Kualifikimi Teknik Kontabiliteti përmbanë gjithsej katër module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimi Teknik Kontabiliteti

### Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Teknik Kontabiliteti

- Për t'u regjistruar si student i IKAF-it në programin Teknik i Kontabilitetit, ju duhet që së paku të keni diplomën e Shkollës së Mesme ose Diplomë Universitare;
- Së paku një (1) vit përvojë pune në kontabilitet/financa – që mund të përfitohet gjatë apo edhe pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar kater (4) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “**Teknik të Kontabilitetit**” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “**Teknik të Kontabilitetit**” e kane obligative ndjeken e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

### Karakteristikat e Ligjertes Trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve; dhe gjatë ligjertes, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjertesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

# **STRUKTURA E SYLLABUSIT**

## **Arsyetimi**

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

## **Diagrami i relacioneve mes moduleve**

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

## **Qëllimi**

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

## **Aftësitë kryesore**

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

## **Temat**

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

## **Struktura e Ekzaminimit**

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

## **Shtojcë Syllabusi i Detajuar**

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

# MODULI

## Arsyetimi

Syllabusi për Librin FMA/F2, Kontabiliteti Menaxherial, i prezanton kandidatëve elementet e kontabilitetit menaxherial të cilat shfrytëzohen për marrjen dhe përkrahjen e vendimeve.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e moduleve

Syllabusi fillon me prezantimin mbi natyrën, burimet dhe qëllimet e kontabilitetit të kostos si dhe teknikat e kostos e përdorura nga biznesi, të cilat janë thelbësore për çdo kontabilist menaxherial. Silabusi pastaj i referohet përgatitjes dhe shfrytëzimit të buxhetit si dhe kostimit standard dhe analizave të variancave, si mjete themelore për planifikimin dhe kontrollin e kostos biznesore. Silabusi përfundon me një paraqitje të matjes dhe monitorimit të performancës së një organizate.

## Qëllimi


Të zhvillojmë njohuritë dhe të kuptojmë si të përgatisim, përpunojmë dhe prezantojmë informatat themelore të kostos, qëllimi i të cilave është që të mbështesin menaxhmentin në planifikim dhe në marrjen e vendimeve në kontekstet e ndryshme biznesore.

## Aftësitë kryesore

- Shpjegojnë natyrën, burimet dhe qëllimet e menaxhimit të informacionit.
- Shpjegojnë dhe zbatojnë teknikat e kontabilitetit të kostos.
- Përgatisin buxhetet për planifikim dhe kontroll.
- Krahasojnë kostot aktuale dhe analizojnë çfarëdo variance.
- Analizojnë, interpretojnë dhe monitorojnë performancën e biznesit.

## Temat

Temat kryesore të Modulit Kontabiliteti Menaxherial që do të trajtohen gjatë ligjerates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulën Kontabiliteti Menaxherial

## Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

## Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 2 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të çdo provimi dy orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

# Syllabusi i Detajuar

## Pjesa A Natyra, burimi dhe qëllimi i informacionit Menaxherial

- a) Kontabiliteti menaxherial 2. Burimet e informacionit
- b) Klasifikimi i kostos
- c) Prezantimi i informacionit

## Pjesa B Teknikat e kontabilitetit të kostos

1. Kontabiliteti për material, fuqinë punëtore dhe shpenzimet e përgjithshme - I  
Kontabiliteti për material, fuqinë punëtore dhe shpenzimet e përgjithshme - II  
Kontabiliteti për material, fuqinë punëtore dhe shpenzimet e përgjithshme - III
2. Kostimi i absorbimit dhe Margjinal – I  
Metodat e kontabilitetit të kostos – II  
Metodat e kontabilitetit të kostos – III
3. Metodat e kontabilitetit të kostos
4. Kontabiliteti i kostos alternative

## Pjesa C Buxhetimi

1. Natyra dhe qëllimi i ushtrimit
2. Teknikat statistikore
3. Përgatitja e buxhetit

4. Buxhetet fleksibile
5. Buxhetimi kapital dhe rrjedhat e skontuara të parasë
6. Kontrolli dhe raportimi buxhetor
7. Aspektet e sjelljes së buxhetimit

## Pjesa D Kostimi Standard

1. Sistemi i kostimit standard
2. Llogaritjet dhe analiza e variancës
3. Buxhetimi Kostimi Standard
4. Harmonizimi i fitimit të buxhetuar me atë aktual

## Pjesa E Matja e performancës

1. Matja e performancës - pasqyra
2. Matja e performancës - zbatimi
3. Reduktimi i kostos dhe rritja e vlerës
4. Monitorimi i performancës dhe raportimi

## Pjesa F Shtojcat

- a) Tabela e vlerës aktuale
- b) Tabela e anuitetit
- c) Fleta e formulave

Fjalori

Indeksi

# Udhëzues Studimi

## A Natyra, burimi dhe qëllimi I informacionit menaxherial

### 1. Kontabiliteti menaxherial

- a. Përshkruani qëllimin dhe rolin e kontabilitetit të kostos dhe kontabilitetit menaxherial në një organizatë.
- b. Krahaso dhe ballafaqo kontabilitetin financiarë me kontabilitetin e kostos dhe kontabilitetin menaxherial.
- c. Përshkruani proceset menaxheriale të planifikimit, vendimmarrjes dhe kontrollit.
- d. Shpjegoni ndryshimin në mes të planifikimit strategjik, taktik dhe operativ.
- e. Bëni dallimin midis të dhënave dhe informacionit.
- f. Identifiko dhe sqaro atributet e informatës së mirë.
- g. Shpjegoni kufizimet e menaxhimit të informatës në ofrimin e udhëzimeve për vendim marrjet menaxheriale.

### 2. Burimet e informacionit

- a) Përshkruani burimet e informacionit brenda dhe jashtë organizatës (duke përfshirë statistikat qeveritare, shtypi financiar, shoqatat profesionale ose tregtare, kuotimet dhe lista e çmimeve).
- b) Sqaroni shfrytëzimet dhe kufizimet e informacionit/të dhënave të publikuara (përfshirë informacionin nga interneti).
- c) Përshkruani ndikimin e ambientit të përgjithshëm ekonomik në kosto/të hyra.
- d) Sqaroni teknikat e zgjedhjes së mostrave (të rastësishme, sistematike, shtresuar,

shumë shkallësh, të grumbullimit dhe kuotës).

- e) Zgjidhni një metodë të përshtatshme të mostrimit në një situatë specifike. (Shënim: derivimi i mostrave të rastit nuk do të shqyrtohen.)

### 3. Klasifikimi i kostos

- a) Shpjegoni dhe ilustro kostot prodhuese dhe joprodhuese.
- b) Përshkruani elementet e ndryshme të kostove joprodhuese - administrative, të shitjes, shpërndarjes dhe financave.
- c) Përshkruani elementet e ndryshme të kostove prodhuese - materialeve, punës dhe shpenzimeve të përgjithshme.
- d) Shpjegoni rëndësinë e dallimit në mes të kostov prodhuese dhe joprodhuese kur vlerësoni rezultatet dhe mallin.
- e) Shpjegoni dhe ilustro me shembuj klasifikimet e shfrytëzuara në analizën e kostove të prodhimit/shërbimeve, përfshirë sipas funksionit, direkte dhe indirekte, fikse dhe të ndryshueshme, kostot fikse të përshkallëzuara dhe ato gjysmë-variable.
- f) Shpjegoni dhe ilustro shfrytëzimin e kodeve në kategorizimin e transaksionit.
- g) Përshkruani dhe ilustro në mënyrë grafike llojet e ndryshme të sjelljes së koston.
- h) Shfrytëzo analizat lartë/poshtë për të ndarë elementet fikse dhe variable e kostove të përgjithshme duke përfshirë situatat gjysmë variable dhe kostot fikse të përshkallëzuara dhe ndryshimet në kostot variable për njësi.
  - i) Shpjegoni strukturën e funksioneve lineare dhe ekuacioneve.



j) Shpjegoni dhe ilustro konceptin e kostos së objektit, njësive të kostos dhe qendrave të kostos .

- i) Bëni dallimin në mes të kostos, fitimit, investimeve dhe qendrave për të hyra.
- j) Përshkruani nevojat e ndryshme për informacionin e kostos, fitimin, investimeve dhe menaxherët e qendrës për llogaritjen e të hyrave.

#### **d) Prezantimi i informacionit**

- b) Përgatitni raportet me shkrim që përfaqësojnë menaxhimin e informacionit në formate të përshtatshme sipas qëllimit të tyre.
- a) Prezantoni informacionin duke shfrytëzuar tabelat, diagramet dhe grafikët (grafikët me shtylla, grafikët me vija, grafikët pite dhe grafikët koordinativ
- b) Interpretoto informacionin (duke përfshirë tabelat lartë, grafikët dhe diagramet) të paraqitura në raportet e menaxhmentit.

### **B Teknikat e kontabilitetit të kostos**

#### **1. Kontabiliteti për material, fuqi punëtore dhe shpenzimet e përgjithshme**

- a) Kontabiliteti për material
  - i. Përshkruani procedurat e ndryshme dhe dokumentet e nevojshme për porositjen, pranimin dhe lëshimin e materialeve nga malli.
  - ii. Përshkruani procedurat e kontrollit të përdorura për monitorimin fizik dhe 'të librave' të mallit dhe për të minimizuar humbjet dhe mospërputhjet.
  - iii. Interpretoto hyrjet dhe bilancet në llogarinë e mallit të materialit.

iv. Identifiko, shpjego dhe llogarit kostot e porositjes dhe mbajtjes të mallit (përfshirë mallin ndarës).

v. Llogaritni dhe interpretoni ri porosinë e sasisë optimale.

vi. Llogaritni dhe interpretoni ri porosinë e sasisë optimale kur zbatohet zbritja.

vii. Bëni llogaritjen për të minimizuar kostot e mallit kur malli rimbushet gradualisht.

viii. Përshkruani dhe zbatoni metoda të përshtatshme për krijimin e niveleve të rirenditura kur kërkesa gjatë periudhës së caktuar është konstante.

ix. Llogaritni vlerën e mallit përmbyllës dhe çështjet materiale duke shfrytëzuar LIFO, FIFO dhe metodat Mesatare.

- b) Kontabiliteti për fuqinë punëtore
  - i. Llogaritni kostot direkte dhe indirekte të fuqisë punëtore.
  - ii. Shpjegoni metodat e shfrytëzuara për ndërlidhjen e inputeve të kostos së punës me punën e kryer.
  - iii. Përgatitni hyrjet në ditar dhe në Libër të përgjithshëm për të regjistruar inpute dhe outputet e kostos së fuqisë punëtore.
  - iv. Përshkruani metodat e ndryshme të pagesave: sistemet të bazuara në kohë, sisteme të bazuara sipas pjesëve të punës si dhe skemat individuale dhe grupe shtytëse.
  - v. Llogaritni nivelet, dhe analizoni kostot dhe shkaqet e qarkullimit të fuqisë punëtore.
  - vi. Shpjegoni dhe llogaritni efikasitetin e fuqisë punëtore, kapacitetin dhe raportet e vëllimit të prodhimit.
  - vii. Interpretoto hyrjet në llogarinë e fuqisë punëtore.
- c) Kontabiliteti për shpenzime operative
  - i. Shpjegoni trajtimin e ndryshëm të shpenzimeve direkte dhe indirekte.

ii. Përshkruani procedurat e përfshira në përcaktimin e raportit absorbues të shpenzimeve operative të prodhimit.

iii. Alokoni dhe shpërndani shpenzimet operative të prodhimit në qendrat e kostos duke përdorur një bazë të përshtatshme.

iv. Rishpërndarja e kostove të qendrës për llogaritje të kostove të shërbimit tek qendra për llogaritje të kostos së prodhimit (duke përdorur metodën reciproke ku qendrat shërbyese të kostos punojnë për njëra tjetrën).

v. Zgjidhni, zbatoni dhe diskutoni bazat e përshtatshme për normat e absorbimit .

vi. Përgatitni hyrjet në ditar dhe librin kryesor për shpenzimet e përgjithshme të shkaktuara dhe absorbuara të prodhimit.

vii. Llogaritni dhe shpjegoni nën absorbimin dhe mbi absorbimin e shpenzimeve të përgjithshme.

## 2. Absorbimi dhe kostoja Margjinale

- a) Shpjego rëndësinë e konceptit të kontributit dhe zbatoje atë.
- b) Demonstro dhe diskuto ndikimin e absorbimit dhe kostos Margjinal e në vlerësimin e mallit dhe përcaktimin e fitimit.
- c) Llogarit fitimin ose humbjen sipas kostos së absorbimit dhe Margjinal e.
- d) Harmonizo fitimet ose humbjet e llogaritura sipas kostos së absorbimit dhe Margjinale.
- e) Përshkruani përparësitë dhe mangësitë e kostos së absorbimit dhe Margjinale.

### d) Metodatat e kontabilitetit të kostos

- a) Kostimi i punës dhe në grumbuj:
  - i. Përshkruani karakteristikat e kostimit të punës dhe kostimit të përgjithshëm.
  - ii. Përshkruani situatat kur shfrytëzimi i kostimit të punës dhe kostimit të përgjithshëm do të ishte e përshtatshme .[K]

iii. Përgatiti shënimet e kostos dhe llogaritë në situatat e kostimit të punës dhe kostimit të përgjithshëm.

iv. Përcakto koston për punë dhe koston e përgjithshme nga informata e dhënë.

b) Procesi i kostimit:

i. Përshkruani karakteristikat e kostimit të procesit.

ii. Përshkruani situatat kur shfrytëzimi i kostimit të procesit do të jetë e përshtatshme.

iii. Shpjegoni konceptet e humbjeve normale dhe jo të zakonshme si dhe fitimet jo të zakonshme.

iv. Llogarit koston për njësi të outputeve të procesit.

v. Përgatitni pasqyrën për procesin që përfshin humbjet normale dhe jonormale si dhe fitimet jonormale.

vi. Llogarit dhe shpjegoni konceptin e njësisë ekuivalente .

vii. Procesi i shpërndarjes së kostove në mes të punës së mbetur në proces dhe transferet jashtë procesit duke përdorur mesataren e ponderuar dhe metodat FIFO.

viii. Përgatit llogaritë e procesit në situatat kur puna nuk është përfunduar.

ix. Përgatit llogaritë e procesit kur humbjet dhe fitimet identifikohen në etapa të e ndryshme të procesit.

x. Bëje dallimin në mes të nënprodukteve dhe produkteve të përbashkëta.

xi. Vlera e nënprodukteve dhe produkteve të përbashkëta në pikën e ndarjes.

xii. Përgatit llogaritë e procesit në situatat kur paraqiten nënproduktet dhe/ose produktet e përbashkëta (Situatat që përfshijnë punët në vazhdim dhe humbjet në këtë proces janë përjashtuar).

c) Kostimi i shërbimeve / operimit

i. Identifiko situatat kur shfrytëzimi i kostimit të shërbimeve /operimeve është i përshtatshme.

ii. Ilustro masa të përshtatshme të koston për njësi që mund të shfrytëzohen në situata të ndryshme të shërbimeve/operimeve.

iii. Kryej analiza të koston së shërbimeve në situata të thjeshta të industrisë së shërbimeve.

#### 4. Kontabiliteti i koston alternative

a) Shpjegoni koston e bazuar në aktivitetet (ABC), koston e synuar, koston e ciklit të jetës dhe menaxhimin total të cilësisë (TQM) si teknika alternative të menaxhmentit të koston

b) Bëni dallimin e ABC, koston të synuar dhe koston të ciklit të jetës nga teknikat tradicionale të koston (shënim: nuk kërkohet të bëhen kalkulime).

#### C Buxhetimi

##### 1. Natyra dhe qëllimi i buxhetimit

a) Shpjegoni pse organizatat shfrytëzojnë buxhetimin

b) Shpjegoni ciklin e planifikimit dhe kontrollit në një organizatë.[k]

c) Shpjegoni procedurat administrative të shfrytëzuara në procesin e buxhetimit.

d) Përshkruani etapat në procesin e buxhetimit (duke përfshirë burimet e të dhënave relevante, planifikimin dhe draft buxhetet e aprovuara dhe qëllimi i parashikimeve dhe si ndërliidhen ato me buxhetimin)

##### 2. Teknikat Statistikore

a) Shpjegoni përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të metodës së lartë të ulët për llogaritjen e elementeve fikse dhe variabile të koston.

b) Ndërtoni diagramet koordinatave dhe vijat e trendit

c) Analizat e të dhënave të koston.

i. Shpjegoni konceptin e koeficientit të korrelacionit dhe konceptin e koeficientit të përcaktimit.

ii. Llogarit dhe interpreto koeficientin e korrelacionit dhe konceptin e koeficientit të përcaktimit.

iii. Krijë një funksion linear duke shfrytëzuar analizat e regresionit dhe interpreto rezultatet.

d) Shfrytëzo koeficientet e regresionit linear për të parashikuar koston dhe të hyrat.

e) Rregullo të hyrat historike dhe të parashikuara për lëvizjet e çmimeve.

f) Shpjegoni përparësitë dhe mangësitë e analizave të regresionit linear.

g) Përshkruani ciklin e jetës së produktit dhe shpjegoni rëndësinë e tij për parashikim.

h) Shpjegoni principet e analizave të serisë kohore (ciklike, trendi, ndryshimi sezonal dhe elementet e rastësishme).

i) Llogarit mesataret lëvizëse.

j) Llogaritja e trendit, përfshirë shfrytëzimin e koeficienteve regresivë.

k) Shfrytëzo variancat e trendit dhe sezonale shtesë dhe multiplikativ) për të parashikuar buxhetin.

l) Shpjegoni përparësitë dhe mangësitë e analizave të serisë kohore.

m) Shpjegoni qëllimin e numrave të indeksit

n) Llogarit numrat e indekseve të thjeshta për një ose më shumë ndryshore

o) Shpjegoni rolin dhe karakteristikat e një sistemi kompjuterikë tabelorë

p) Identifiko aplikacionet për paraqitje tabelore kompjuteristike dhe shfrytëzimi i tyre në kontabilitetin e koston dhe menaxherial

### 3. Përgatitja e buxhetit

- a) Shpjegoni rëndësinë e faktorit të buxhetit kryesorë në përgatitjen e buxheti
- b) Përgatitni buxhetet e shitjes.
- c) Përgatitni buxhetet funksionale (prodhimin, përdorimi dhe blerjet e lëndëve të para, puna shpenzimet e përgjithshme variable dhe fikse).
- d) Përgatitni buxhetet e parasë
- e) Përgatitni buxhetet e përgjithshme (pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e pozitës financiare).
- f) Shpjegoni dhe ilustroni analizën 'çka nëse' dhe planifikimin sipas skenarit.

### 4. Buxhetet fleksibile

- a) Shpjegoni rëndësinë e buxheteve fleksibile në kontroll.
- b) Shpjegoni mangësitë e buxheteve fleksibile në kontroll.
- c) Identifiko situatat kur kontrollet buxhetore fikse apo fleksibile do të ishin të përshtatshme.
- d) Bëni një buxhet fleksibil në një nivel të dhënë vëllimi.

### e) Buxhetimi i kapitalit dhe rrjedha e skontuar e parasë

- a) Diskuto rëndësinë e planifikimeve të investimeve kapitale dhe kontrollit.
- b) Nënvizohet çështjet për të marrë parasysh dhe hapat e përfshirë në përgatitjen e një buxheti të shpenzimeve kapitale.
- c) Shpjegoni dhe ilustroni dallimin në mes të interesit të thjeshtë dhe të përbërë, dhe në mes të normave nominale dhe efektive të interesit.
- d) Shpjegoni dhe ilustroni kapitalizimin dhe skontimin.
- e) Shpjegoni dallimin në mes të rrjedhës së parasë dhe fitimit dhe rëndësinë e rrjedhës

së parasë për vlerësimin e investimeve kapitale.

- f) Identifiko dhe vlerëso rrjedhën përkatëse të parasë për vendimet e investimeve individuale.
- g) Shpjegoni dhe ilustroni vlerën aktuale neto (NPV) dhe normën e brendshme të kthimit (IRR) metodat e rrjedhës së parasë së skontuar.
- h) Llogarit vlerën aktuale duke përdorur formulat e anuiteit dhe perpetuity formulae.
- i) Llogaritni NPV, IRR dhe kthimin (të skontuar dhe jo të skontuar).
- j) Interpretoni rezultatet e kalkulimeve të NPV, IRR dhe kthimit të realizueshmërinë të investimeve.

### e) Kontrolli buxhetor dhe raportimi

- a) Llogarit variancat e thjeshta në mes të buxhetit fleksibil, buxhetit fikse dhe shitjeve aktuale, kostove dhe profiteve.
- b) Diskutoni rëndësinë relative të variancave.
- c) Shpjegoni veprimet potenciale për të eliminuar variancat.
- d) Përcakto konceptin e kontabilitetit të përgjegjësive dhe rëndësinë e tij për kontrollin.
- e) Shpjegoni konceptin e kostove të kontrollueshme dhe të pakontrollueshme.
- f) Përgatitja e raporteve të kontrollit të përshtatshme për prezantim menaxhmentit (të përfshijë rekomandimin e veprimit të duhur të kontrollit)

### 8. Aspektet e sjelljes buxhetore

- a) Shpjegoni rëndësinë e motivimit në matjen e performancës.
- b) Identifiko faktorët në planifikimin buxhetor dhe sistemin e kontrollit që ndikojnë në motivim.
- c) Shpjegoni ndikimin e caqeve mbi motivimin.

- d) Diskuto skemat stimuluese të menaxhmentit.
- e) iskuto përparësitë dhe mangësitë të qasjes pjesëmarrëse të buxhetimit.
- f) Shpjegoni qasjet poshtë-lartë, lartë-poshtë ndaj buxhetimit.

## **D Kostimi standard**

### **1. Sistemet standarde të kostimit**

- a) Shpjegoni qëllimin dhe parimet e kostimit standard.
- b) Shpjegoni dhe ilustro dallimet në mes të kostimit standard, Margjinal dhe absorbues.
- c) Caktoni koston standarde për njësi sipas koston absorbuese dhe Margjinale.

### **2. Llogaritja e variancës dhe analizat**

- a) Llogarit çmimet e shitjes dhe madhësinë e variancës .
- b) Llogarit materialin e përgjithshëm, variancat e shfrytëzimit dhe çmimit.
- c) Llogarit punën e përgjithshme, variancat e shkallës dhe efikasitetit.
- d) Llogarit totalin e shpenzimeve variabël, variancat e shpenzimeve dhe efikasitetit.
- e) Llogarit totalin e kostove fikse, shpenzimeve dhe ku është e përshtatshme, variancën e kapacitetit të madhësisë dhe efikasitetit.
- f) Interpretu variancat.
- g) Shpjegoni faktorët që duhet marrë parasysh para hetimit të variancave, shpjegoni shkaqet e mundshme të variancave dhe rekomando masa të kontrollit.
- h) Shpjegoni ndërlidhjet në mes të variancave.
- i) Llogarit shifrat aktuale ose standarde kur janë të dhëna variancat.

### **3. Harmonizimi i fitimit të buxhetuar dhe buxhetit aktual**

- a) Harmonizo fitimin e buxhetuar me fitimin aktual sipas koston standarde të absorbimit
- b) Harmonizo fitimin e buxhetuar ose kontributin me fitimin aktual sipas koston standarde Margjinal e

## **E Matja e Performancës**

### **1. Matja e Performancës - pasqyrë**

- a) Diskutoni qëllimin e deklaratave të misionit dhe rolin e tyre në matjen e performancës.
- b) Diskutoni qëllimin e objektivave strategjike, operative dhe taktike dhe rolin e tyre në matjen e performancës.
- c) Diskutoni ndikimin e kushteve ekonomike dhe të tregut në matjen e performancës.
- d) Shpjegoni ndikimin e rregullores qeveritare në matjen e performancës.

### **2. Matja e performancës - zbatimi**

- a) Diskutoni dhe llogaritni masat e performancës financiare (rentabiliteti, likuiditeti, veprimtaria dhe ingranimi) dhe masat jo financiare.
- b) Perspektivat e fletënotimit të balancuar
  - i. Diskutoni përparësitë dhe kufizimet e fletënotimit të balancuar.
  - ii. Përshkruani indikatorët e performancës për suksesin financiar, kënaqësinë e klientëve, efikasitetin e procesit dhe rritjen.
  - iii. Diskutoni faktorët kritikë të suksesit dhe treguesit kyç të performancës dhe lidhja e tyre me objektivat dhe deklaratat e misionit.
  - iv. Krijoni faktorët kritikë të suksesit dhe treguesit kyç të performancës në një situatë specifike.

c) Ekonomizimi, efikasiteti dhe efektiviteti  
i. Shpjegoni konceptet e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit.

ii. Përshkruani treguesit e performancës për ekonomizim, efikasitet dhe efektivitet.

iii. Krijë treguesit e performancës për efikasitet dhe efektivitet në një situatë specifike.

iv. Diskutoni kuptimin e secilit prej treguesve: efikasitetit, kapacitetit dhe aktivitetit.

v. Llogarit treguesit e efikasitetit, kapacitetit dhe aktivitetit në një situatë specifike.

d) Kostot për njësi

i. Përshkruani masat e performancës që do të jenë të përshtatshme në kontratë dhe mjediset e procesit të kostimit.

e) Shfrytëzimi i Burimeve

i. Përshkruani masat e përdorimit të performancës në shërbime dhe mjedise prodhuese.

ii. Vendosni masa të shfrytëzimit të burimeve në një situatë specifike.

f) Rentabiliteti

i. Llogarit kthimin në investime dhe të ardhurat e mbetura.

ii. Shpjegoni përparësitë dhe kufizimet e kthimit në investimet dhe të hyrat e mbetura.

g) Cilësia e shërbimit

i. Dalloni çështjet e matjes së performancës në industrinë prodhuese dhe shërbyese.

ii. Përshkruani masat e përshtatshme të performancës për industrinë shërbyese.

#### **4. Zvogëlimi i kostos dhe rritja e vlerës**

a) Krahaso kontrollin e kostos dhe zvogëlimin e kostos.

b) Përshkruani dhe vlerëso metodat e zvogëlimit të kostos.

c) Përshkruani dhe vlerëso analizat e vlerës.

#### **5. Monitorimi i performancës dhe raportimi**

a) Diskutoni rëndësinë e masave të performancës jo financiare.

b) Diskutoni marrëdhënien në mes të performancës afatshkurtër dhe afatgjatë.

c) Diskutoni matjen e performancës në situata të industrisë shërbyese.

d) Diskutoni matjen e performancës organizatat jo fitimprurëse dhe organizatat e sektorit publikë.

e) Diskutoni masat që mund të shfrytëzohet për të vlerësuar performancën menaxheriale dhe problemet praktike të përfshira.

f) Diskutoni rolin e krahasimit në matjen e performancës.

g) Përpilo raporte ku theksohen fushat kyçe për vëmendjen e menaxhmentit dhe rekomandimet për përmirësim.